37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-24-8521-5-1-1/C1042

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë brenda 24 muajve, sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Ekipi për Menaxhimin e Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 25 muaj .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikim teknik që favorizojnë ose disfavorizojnë një ose me shumë operatorë ekonomik.

Specifikimet teknike për gypa të paraizoluar dhe pjesët percjellëse të ngrohjes qendrore

1. Komponentët e gypave të paraizoluar


1.1 Të përgjithshme

Komponentët e dorëzuar të gypave të paraizoluar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- sistem i përbërë për instalim të drejtpërdrejtë, pa kanal, për temperaturat e funksionimit deri në 130°C dhe temperaturat afatshkurtra 140°C (500 orë p. a.);
- **Gypa të drejtë të paraizoluar sipas EN 253;**
- T-lidhëse të parafabrikuara, kthesa të parafabrikuara dhe pika fiksimi të parafabrikuara sipas EN 448;
- valvola mbyllëse me tokëzim sipas EN 488;
- nyjet e mëngëve sipas EN 489; dhe
- performanca në përputhje me udhëzimet e teknologjisë së ngrohjes qendrore: EN13941, projektimi dhe instalimi për sistemet e tubacioneve të izoluar paraprakisht.

Prodhimi i shumës PUR duhet të bëhet me një faktor zvogëlues të ozonit zero dhe një faktor të ulët potencial për ngrohjen globale.

Përçueshmëria termike e tubit të paraizoluar të pavyjekur duhet të jetë më e ulët se 0,029 W/(m*K) (agjent fryrës Ciklopentani). Lloji dhe udhëzimet e përgatitjes së shumës duhet të specifikohen brenda fakturës së dorëzimit.



Tuba prej çeliku mesatar duhet të transportojnë ujë të nxehtë. Në këto temperatura ata duhet të përballojnë sforcimet mekanike, të shkaktuara nga presioni i brendshëm, zhvendosjet e tubave, fërkimi i jashtëm, toka dhe ngarkesa e trafikut. Për më tepër, tubat mesatar prej çeliku duhet të përballojnë të gjitha ndikimet kimike të ujit të nxehtë.

Të gjithë tubat dhe komponentët e çelikut të përdorur duhet të dorëzohen minimalisht me një 3.1.B. certifikatë sipas EN 10204.

1.2 Gypa çeliku

DN 20 deri në DN 600 me cilësi të përcaktuar sipas PN 16, sipas kushteve teknike të furnizimit EN 10217-1, -2, -5 dhe EN 10216-2, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në tabelën e mëposhtme.

Gjatësia e dorëzimit deri në DN100 në gjatësi 6 ose 12 m, nga DN200 opsionale në gjatësi 12 ose 16 m.

Të përgjithshme: P 235 GH sipas EN 253, në përputhje me EN 10216-2, EN 10 217-2 ose 10217-5.

Dimensionet, matjet dhe vlerat statike sipas EN 253, në përputhje me EN 10216-2, EN 10217-2 ose 10217-5 dhe ENV 10220.

Për dimensionet deri në DN 100 duke përfshirë:

Tub çeliku i zi pa tegel, materiali P 235 GH TH1 sipas EN 10216-2 (1.0345)

Nga trashësia e murit > 3,2 mm me përgatitjen e tegelit të saldimit përmes skajeve të pjerrëta në përputhje me EN 10216 dhe EN 10217.

Për dimensionet mbi DN 100:

Tub çeliku i zi i salduar, materiali P 235 GH TH1 sipas EN 10 217 (1,0345), i salduar me frekuencë të lartë, me tegel gjatësor ose me hark.

Nga trashësia e murit > 3.2 mm me përgatitjen e tegelit të saldimit përmes skajeve të pjerrëta në përputhje me EN 10216 dhe EN 10217.

Dimensionet e tubave të paraizoluara në lidhje me diametrin nominal, diametrin e jashtëm dhe trashësinë minimale të murit të tubit të çelikut sipas tabelës së mëposhtme:

Nominal diameter	Outer diameter PE-pipe in mm	Outer diameter and minimum wall thickness in mm
DN 200	315	219,1 x 4,5

DN 250	400	273,0 x 5,0
DN 300	450	323,9 x 5,6

1.3 Njësia e gypave të paraizoluar

Nuk duhet të tejkalohet ekscentriciteti i boshtit të tubit (mesatar çeliku dhe tubi me mbështjellës PEHD) sipas EN 253.

Hapësirat përbëhen nga poliamidi dhe duhet të kenë një formë të tillë prejje tërthore, që pas ndarësit të mos krijohen pore të paprueshme ose ajër të bllokuar. Si teknikë alternative mund të aplikohet edhe procesi i shkumëzimit të vazhdueshëm (shkumëzimi pa ndarës). Sasia e ndarësve duhet të marrë parasysh devijimin dhe peshën e tubit të mesëm.

Telat e kontrollit të sistemit të kontrollit të rrjetit do të vendosen në shkumë.

Përpara se të fillojë procesi i shkumëzimit, të gjithë komponentët duhet të kenë të njëjtin nivel temperature (rreth 18°C).

Tubat me mbështjellës PEHD duhet të jenë të fabrikuar nga polietileni me densitet të lartë (PEHD) dhe duhet të trajtohen me koronë sipas EN 253 për ngjitje optimale me shkumën e fortë PUR. Trashësia e murit të tubit PEHD duhet të jetë së paku në përputhje me EN 253.

Për sa i përket sjelljes mekanike afatgjatë, tubi me mbështjellës PEHD duhet të përballojë një stres mekanik prej 4 MPa për 1500 orë në 80°C.

Në rastin e segmenteve të përkuljes PEHD; këto bashkohen duke përdorur një pajisje saldimit me pasqyrë dhe saldohen në prapnicë. Saldimet me fileto për copat e degëve kryhen me një njësi saldimit ekstruder.

Për konstruksionet me linja të hapura brenda dhe jashtë ndërtesës do të përdoren tuba spiro-palosje-xhakëtë (tuba spirale të palosur çeliku të galvanizuar) sipas DIN 24145.

1.4 Pjesët e formuara

Pjesët e formuara të parafabrikuar të izoluara duhet të plotësojnë kërkesat sipas EN 448. Trashësia e murit të tubave prej çeliku të zinj të salduar dhe pa tegel të pjesëve dhe tubave të formuara përpara përpunimit duhet të jetë e njëjtë me trashësinë e murit me trashësinë e murit të tubave të drejtë.

- Kthesat e gypave sipas EN 10253 pjesa 2.
- Gypa T-lidhese sipas EN 10253 pjesa 2.
- Tuba T-degë për ventilin sipas EN 10253 pjesa 2.
- Komponentët reduktues sipas EN 10253 pjesa 2.

1.5 Pikat e fiksimit

Pikat e fiksimit për gypat e paraizoluar mund të jenë të nevojshme nëse tubat e izoluar janë të lidhur me sisteme të tjera shtrimi.

Për fiksimin e tubave të paraizoluar në tokë duhet të ndërtohet një bllok betoni i cilësisë B 25K II sipas DIN 1045 duke përfshirë armaturën e nevojshme të Bst 4 RK sipas DIN 488 nga një konstruktor ndërtimi.

Fllanxha e çelikut në pikën e fiksimit në konstruksionin e pllakës duhet të projektohet për ngarkesa maksimale $L_{max}/2$ dhe duhet të transmetojë forcat që ndodhin në bllokun e betonit me dimensione përkatëse. Fllanxha e çelikut duhet të jetë e ndarë termikisht dhe elektrikisht nga tubi mesatar.

Për më tepër, të njëjtat kërkesa cilësore të vlefshme për gypat e drejtë të paraizoluar duhet të plotësohen.

1.6 Valvulat mbyllëse

Valvulat mbyllëse të parafabrikuara të izoluara (valvulat e topit) duhet të plotësojnë kërkesat sipas EN 488. Për më tepër, kërkesat e mëposhtme duhet të plotësohen:

- i testuar sipas tipit
- dizajn plotësisht i salduar
- Material topash prej çeliku inox me kalim të plotë
- pranimi i presionit nga të dyja palët
- i përshtatshëm për Instalim të ftohtë
- material izolues PTFE me grafit
- Materiali kërcell i bërë prej çeliku inox me sistem të tepërt vulosjeje, paketim PTFE dhe unazë EPDM-O
- shënjimi i përhershëm për të treguar motin se valvula e topit është e hapur ose e mbyllur
- Dimensioni ballë për ballë 1,0 m
- sistem i integruar i kontrollit të rrjetit me tela kontrolli të ngritur në shtyllë
- valvulat e topit duke filluar nga DN 200 duhet të parashikohet një opsion për ingranazhet me prizë; nga trashësia e murit $> 3,2$ mm me përgatitjen e tegelit të saldimit përmes skajeve të pjerrëta në përputhje me ISO 10217-2/5.
- Certifikata e testit të pranimit në përputhje me EN 10204/3.1
- Testi i rrjedhjes në secilën valvul mbyllëse sipas EN 12266, pjesa 1, shkalla e rrjedhjes A.

Për më tepër, të njëjtat kërkesa cilësore të vlefshme për gypat e drejtë të paraizoluar duhet të plotësohen.

1.7 Valvola mbyllëse - të kombinuara

Valvulat mbyllëse - combi janë valvula mbyllëse të parafabrikuara të izoluara me dalje të integruara për ventilim dhe kullim.

Valvulat e mbylljes – combi duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa si valvulat mbyllëse të përmendura tashmë në seksionin 3.6.

Dimensionet e vlerësuara për ventilim dhe/ose kullim:

- vendkalimi i valvulës mbyllëse $\leq$ DN 65 $\rightarrow$ $\geq$ DN 20
- vendkalimi i valvulës mbyllëse $\geq$ DN 80 $\rightarrow$ $\geq$ DN 50

Valvulat e topit të integruara në daljet për ventilim dhe kullim duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- valvul topthi me trup çeliku C 22.8 dhe skajet e salduara
- material topash i bërë prej çeliku inox me kalim të reduktuar
- Material izolues PTFE dhe material EPDM-O-unazë

Këto kërkesa janë gjithashtu të vlefshme për valvulat me top që përdoren në degët T të parafabrikuara për ventilim ose kullim.

1.8 Pajisje për valvulat mbyllëse

Duhet të shtohen veshjet e zgjatjes së kërcellit, nëse valvulat mbyllëse janë instaluar në thellësi të mëdha. Përfshirë në fushën e furnizimit të një grupi zgjatues të kërcellit është një dado katrore konike që duhet të vendoset dhe të fiksohet në një shtyllë standarde të valvulës mbyllëse.

Ingranazhet e folesë përdoren për të funksionuar valvulat mbyllëse të vendosura në tokë dhe duhet të përshtaten për shtyllat standarde ose veshjet e zgjatjes së kërcellit.

1.9 Lidhjet e mëngëve

Lidhjet e mëngëve duhet të plotësojnë kërkesat sipas EN 489.

Lidhjet e mëngës duhet të sigurojnë një lidhje të përhershme dhe të papërshkueshme nga uji të tubave të paraizoluara nën streset termike dhe mekanike që ndodhin brenda dhe jashtë. Një zhvendosje e bashkimit të mëngës duhet të shmanget në të gjitha kushtet e funksionimit të tubacionit.

Janë të pranueshme nyjet e dyfishta si dhe të ndërlydhura.

Lidhjet e mëngës së fundit përdoren për mbylljen e mbaresave të tubave të paraizoluara në tokë të përbërë nga një bashkim i vetëm me mëngë PEHD me një kapak të verbër si dhe një jakë tkurrje. Mbi kapakun e verbër duhet të montohet gjithmonë një jastëk zgjerimi. Lidhjet e mëngës fundore kanë të njëjtat kërkesa teknike si nyjet e mëngës së përshkruar më sipër.

Kapakët fundore mbrojnë shumën PUR në skajet e tubave të paraizoluara në ndërtesa ose bosht nga depërtimi i lagështirës. Të gjitha kapakët fundorë përbëhen nga një poliolefinë tkurrëse nga nxehtësia, e ndërlydhur molekulare, e modifikuar dhe për rrjedhojë jo e shkrirë dhe janë të mbuluara në të dy skajet me një ngjitës izolues rezistent ndaj temperaturës, veçanërisht të formuluar.

Kthesa PE të montuara në kantierin e ndërtimit. Pjesët e montimit në PE do të përshtaten sipas formës së kërkuar, do të saldohen me PE dhe do të shkumohen me shkumë PUR. Të njëjtat kërkesa teknike janë të vlefshme si për nyjet e mëngëve.

PE-dega e montuar në kantier ndërtimi. Të njëjtat kërkesa teknike janë të vlefshme si për nyjet e mëngëve.

Lidhjet e mëngëve reduktuese të PE. Të njëjtat kërkesa teknike janë të vlefshme si për nyjet e mëngëve

1.10 Jastëkë zgjerimi

Jastëkët e zgjerimit përdoren për të thithur lëvizjet e tubacioneve të izoluar paraprakisht në kthesat L-, Z- dhe U, në degët, në nyjet reduktuese dhe fundore, në pajisjet mbyllëse si dhe në pikat e larta dhe të ulëta.

Të gjitha llojet e jastëkëve të zgjerimit përbëhen nga material polietileni i shkumëzuar me qeliza të mbyllura që i reziston kalbjes dhe kimikateve me një shtresë të jashtme të fortë dhe të rrethuar plotësisht. Shtresa e brendshme e jastëkëve të zgjerimit duhet të jetë e butë me densitet të ulët dhe trashësi maksimale 120 mm. Nëse kërkohen shtresa me një trashësi më të madhe se trashësia standarde e jastëkut të zgjerimit, dy ose më shumë jastëkë duhet të ngjiten duke u ndezur njëra mbi tjetrën.

Jastëkët e zgjerimit duhet të ofrojnë sforcime mekanike prej të paktën 0,01 N/mm² në një deformim prej 10% dhe stres maksimal mekanik prej 0,10 N/mm² në një deformim prej 50% (me ngurtësi mesatare).

Një jastëk i zgjerimit të njehsorit të rrjedhshëm përbëhet nga dy copa shiritash për montim anash në pozicionin e orës 3 dhe 9, si dhe me një zonë të petëzuar të jashtme të ngurtë të petëzuar për mbulimin e plotë të tubit të shtresës PEHD në një vend të mbyllur, formë horizontale-ovale. Kjo parandalon akumulimin e nxehtësisë dhe parandalon që dheu të rrjedhë midis tubit të shtresës së jashtme dhe jastëkut.

1.11 Tranzicione muri të papërshkueshëm nga uji

Unazat mbyllëse ose futjet përdoren për të parandaluar hyrjen e ujit në ndërtesa, boshte ose kanale betoni.

Unaza mbyllëse e bërë nga gome sintetike duhet të jetë e pandjeshme në lidhje me uljen e mëvonshme të tubave të izoluar paraprakisht dhe në lidhje me lejimet e ovalitetit dhe diametrit të tubave me shtresë HDPE.

Kalimet e murit duhet të lejojnë zhvendosjet boshtore të tubave të paraizoluar.

Të dhëna më të detajuara do të jepen nga Kontraktori dhe udhëzimet e tij duhet të ndiqen me kujdes.

Unazat e përshkruara të vultosjes përdoren për instalimin e tranzicioneve në mur për ujë pa presion.

Në rastin e presionit të ujit, duhet të instalohen tranzicione në mur, të cilat përbëhen nga një mbyllje e dyfishtë me dy shtresa mbyllëse me vulosje gome EPDM-FULL secila e përshtatshme për izolim ndaj ujit të shtypur. Të gjitha materialet janë të veshura me zink galvanik.

1.12 Sistemi i kontrollit të rrjetit

Do të aplikohet sistemi i kontrollit të rrjetit sipas Sistemit Nordik (Sistemi Evropian i monitorimit) në përputhje me EN 14419. Funkzioni i monitorimit në lidhje me shkëputjen e telave të kontrollit dhe në lidhje me bazat e depërtimit të lagështisë sipas parimit të matjes së rezistencës elektrike. Vendndodhja e gabimit do të kryhet duke përcaktuar kohën e ekzekutimit.

Sistemi i kontrollit të rrjetit do të instalohet brenda gjithë gjatësisë së tubacionit në çdo seksion. Diagrami i lidhjeve duhet të përpunohet në bashkëpunim me Punëdhënësin.

Në rast të montimit të sistemit të kontrollit të rrjetit nga Kontraktori duhet të instalohen të gjithë komponentët e vetëm të sistemit.

Përbërësit e Sistemit Nordik:

- tela bakri jo të izoluar me një seksion kryq prej 1,5 mm², ndërsa një tel bakri është i veshur me kallaj për shkak të problemeve të diferencimit;
- kutitë e nevojshme për lidhjen e telave për kërcimin dhe shpërndarjen e telave matëse dhe sensorë me një ose më shumë blloqe terminale 5-polëshe, klasa e mbrojtjes IP 65;
- kuti matëse për lidhjen nëpërmjet një spine shumëpolëshe me një testues sistemi portativ ose një pajisje matëse të pajtueshme me PIN për monitorim manual, klasi i mbrojtjes IP 65;
- testues manual portativ i sistemit për kryerjen e matjeve të inspektimit dhe monitorimit rrotullues, manual të rrjeteve më të vogla të tubacioneve;
- kablllo lidhëse e rezistencës për instalimin e telave të sensorit me kuti instalime elektrike dhe njësi monitorimi;
- pjesët fundore të telit; dhe
- sensorit i lidhjes së mundshme

Montimi i sistemit të kontrollit të rrjetit:

- Telat e kontrollit duhet të vendosen në pozicionin e orës njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë;
- Telat e kontrollit duhet të fiksohen në mënyrë që shkuma PUR e futur të mos shkaktojë ndonjë zhvendosje;
- Lidhja ndërmjet telave të kontrollit duhet të ndërtohet duke shtrëdhur duke marrë parasysh shënime të ngjyra të telave të kontrollit;

- Lidhjet me kutitë lidhëse dhe pajisjen e centralizuar të monitorimit duhet të ndërtohen siç duhet dhe në mënyrë të përshtatshme; dhe
- Lidhjet e mëngës duhet të shikohen menjëherë pas montimit të sistemit të kontrollit të rrjetit

Inspektimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të rrjetit:

- Ndryshimet e kushteve në këtë seksion kërkojnë pranimin e Punëdhënësit; dhe
- Në përgjithësi, sistemi i kontrollit të rrjetit duhet të testohet për besueshmërinë e tij funksionale në çdo tub të paraizoluar përpara se nyjet e mëngës të mbushen me shkumë PUR

2 Artikuj të tjerë të përshtatshëm

2.1 Shiriti paralajmërues i gjurmës


Shiriti paralajmërues i gjurmës përdoret për identifikimin e tubacioneve të shtrura me tokë në pozicionin e orës 12 mbi tubacionet e furnizimit dhe kthimit. Shiriti paralajmërues i gjurmës do të dorëzohet në rrotulla 40 mm të gjera dhe 250 m të gjata me fjalët "Vëmendje! Tub i Ngrohjes Qendrore" i printuar në të zezë në një sfond të verdhë.

3. Dokumentacioni i sistemit të plotë të tubave të paraizoluar

Dokumentacioni tregon garancinë e vazhdueshme të cilësisë së produkteve të dorëzuara. Dokumentet në gjuhën angleze dhe shqipe (aty ku është e aplikueshme) duhet të jepen si lidhëse unazash të lidhura.

Brenda dokumentacionit duhet të përfshihen dokumentet e mëposhtme:


- Përshkrime të përgjithshme të sistemit, materialit dhe funksionit të komponentëve dhe produkteve të tubave të paraizoluar;
- Të dhënat teknike dhe dimensionet e materialeve dhe produkteve të dorëzuara;
- Udhëzimet e montimit në lidhje me transportin, magazinimin, punimet civile dhe të ndërtimit të tubacioneve si dhe punimet e vulosjes në;
- Të gjitha certifikatat e kërkuara për vënien në punë të materialit, si dhe certifikatat e prodhuesit dhe të garancisë së cilësisë;
- Përshkrimi i funksioneve, nisja manuale e funksionimit, vënia në punë dhe dorëzimi i procesverbeleve të sistemit të kontrollit të rrjetit (nëse është e aplikueshme). Dokumentacioni i sistemit të kontrollit të rrjetit duhet të përfshijë raportet e matjes së sistemit të kontrollit të rrjetit sipas të dhënave të matura të gjendjes së ndërtuar, nëse është e nevojshme e ndarë në seksione të marra me procedurat e duhura të matjes;
- Plani i shkallëzuar i lidhjeve të sistemit të kontrollit të rrjetit me tregues të të gjithë komponentëve të instaluar të sistemit si kopje e printuar ose skedar DXF;




- o Dokumentacioni (nëse është i aplikueshëm) duhet të përfshijë raportin e nyjeve lidhëse në lidhje me punimet e izolimit dhe vulosjes, të numëruar kronologjikisht; dhe
- o Rezultatet e vlerësimit të llogaritjeve statike të tubave të cilat duhet të sigurohen nga Kontraktori.

4. Dizajn

Kontraktori do të ndërmarrë një kontroll të projektimit të bazuar në softuer, kryesisht por jo ekskluzivisht në lidhje me zgjerimin termik dhe stresin mekanik. Bazuar në këto përlllogaritje dhe kontrole, Kontraktori do të vlerësojë projektin teknik përfundimtar duke përfshirë përzgjedhjen përfundimtare të pajisjeve.







Name	Dim			
	Steel pipe		Casing	
	ø out. mm	wall thick. mm	ø out. (Do) mm	wall thick. mm
DN25/90	33.7	2.6	90	3.0
DN32/110	42.4	2.6	110	3.0
DN40/110	48.3	2.6	110	3.0
DN50/125	60.3	2.9	125	3.0
DN65/140	76.1	2.9	140	3.0
DN80/160	88.9	3.2	160	3.0
DN100/200	114.3	3.6	200	3.2
DN125/225	139.7	3.6	225	3.4
DN150/250	168.3	4.0	250	3.6
DN200/315	219.1	4.5	315	4.1
DN250/400	273.0	5.0	400	4.8
DN300/450	323.9	5.6	450	5.2
DN350/500	355.6	5.6	500	5.6



Standard Chamber for Pre-insulated Valves



Cross-section B





&



Per: Komuna e Gjakovës

Nga: Konzerciumi "Lika Trade sh.p.k & Lika Company" sh.p.k

Datë: 08.10.2024

DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUSHME

Konzorciumi "Lika Trade sh.p.k" me NUI:810218116 me pronar Sali Likaj & "Lika Company" sh.p.k me NUI:811551565 me pronar Jahir Likaj deklarojnë se i pranojnë të gjitha specifikimet teknike të detyrueshme në Dosjen e tenderit për projektin me titull:

Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit

Me numër të prokurimit: 632-24-8521-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 632-24-0104-511

Lika Trade sh.p.k

Sali Likaj




Lika Company sh.p.k

Jahir Likaj




Projekti kryesor i rehabilitimit të Transitit të Vjetër,					
Paramasa dhe Parallogaria					
I. Rruga					
L=1+570.00 km, B=14.50 m, C=2x1.2m, Tr=2x6.0m					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtës. (Zyra të ketë kushte të mira për punë të jete e paisur me inventar, printer, internet, të ketë tavolin shtesë - të veçantë për projekt menaxherin dhe organin mbikëqyrës).	komplet	1.00	5,000.00	5,000.00
2	Pastrimi i terenit dhe largimi i të gjitha pengesave në trasenë e rrugës e që përfshinë, demolimin e bazamenteve të shtyllave (reklama-dimensionet max 1.0x1.0x0.5 m) largimin e mobilerisë urbane (shporta shtylla antiparking etj), rrethoja dekorative ekzistuese me lartësi më të vogël se 60 cm, shenjave ekzistuese të komunikacionit si dhe transporti i materialeve në deponitë përkatëse të përcaktuara nga investitori max 15 km.	m'	1,570.00	2.00	3,140.00
3	Kontrollimi, ruajtja dhe sigurimi instalimeve nëntokesore ekzistuese gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve. Në rastë demtimi të instalime ekzistuese (që janë të bashkangjitur në projekt sipas informatave nga kompanit regjionale) duhet të rregulloj vetë punëkryesi. Përgjatë traseseë shtrihen rrjetet e infrastruktures si: - Instalimet e rrjetit të ujësjetës - Rrjeti elektrik, - Rrjeti i instalimeve të telekomunikimit, dhe veçanërisht fibrin optik që kalon në anën e djathtë të rrugës. - Rrjeti i ngrohës së qytetit.	m'	1,570.00	3.00	4,710.00
4	Prerja e drunjeve (ose dislokimi) dekorativ dhe lisave të cilët gjenden në trupin e rrugës, trotuareve dhe në pjesët ku bëhet zgjerimit. Drunjët kanë lartësi nga 2.0 m deri në 10 m. Në këtë pozicion përfshihet prerja (ose dislokimi) dhe largimi i materialit në deponi, max 15 km të caktuar nga investitori	copë	60.00	30.00	1,800.00


1. A.F. 

2. E.Q. 

3. A.K. 

5	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në këtë pozicion përfshihet shënjimi i koordinatave në profilet e rrugës, kontrollimi i niveleve gjatë ekzekutimit të punimeve, si niveli i gërmimi, mbushjes, trashësisë së shtresave, piktimi i elementeve, si gurët skajorë, muret, rrethojat, respektivisht barjta e të gjitha informatave nga projekti në trase si dhe kontrolli i tyre gjatë ekzekutimit të punimeve.	m'	1,570.00	3.00	4,710.00
6	Demolimi dhe gurve skajor 18/24 cm së bashku me beton dhe transporti i materialeve të demoluara në deponi e materialeve inerte të caktuar nga investitori me transport max 15 km. Në këtë pozicion përfshihet demolimi i gurëve skajor: - në të dy skajet e rrugës ekzisuese - në të dy anet ishullit të gjelbërt në mesin e rrugës, - në rrethrotullimi e kryqëzimit të transitit me rrugën UÇK, si dhe ishujve të rrugëve anësore - në rrethrotullimin në kryqëzimi me rrugën Skenderbeu, kyçja nga drejtimi Prizrenit, - në kryqëzimet me rrugët anësore që qasen në këtë rrugë, për gjatësinë sipas projektit mesatarisht 20m nga skaji i rrugës ekzistuese, - si dhe gurëve tjerë skajor në ishujt e gjelbërt përgjatë trasë së rrugës.	m'	6,780.00	2.00	13,560.00
7	Demolimi dhe gurve skajor 10/20 cm dhe 8/20 cm së bashku me beton dhe transporti i materialeve të demoluara në deponi e materialeve inerte të caktuar nga investitori me transport max 15 km. Në këtë pozicion përfshihen të gjithë gurët skajor anash trotuareve, dhe ishujve të gjelbërimit, si dhe shtigjeve ekzistuese të çiklistëve.	m'	2,180.00	2.00	4,360.00
8	Demolimi i shtresës së sipërme të trotuareve ekzistuese si dhe transporti i materialit të demoluar deri në deponi të materialeve inerte të përcaktuar nga investitori me transport max. 15 km. Trotuaret ekzistuese, janë të shtruara me materiale të ndryshme, si: kubza betoni, asfalt, dhe beton.	m ²	19,527.50	1.00	19,527.50
9	Demolimi i rrethojave ekzistuese metalike që gjenden, anash rrugës. Në këtë pozicion janë përfshirë rrethojat ekzistuese nga profilet metale të vendosura me themele të veçuara. Në kuadër të këtij pozicioni përfshihet prerja, demontimi i rrethojës, demolimi i themeleve të betonit dhe transporti i deri në deponinë e përcaktuar nga investitori me largësi deri në 15 km	m	160.00	10.00	1,600.00

1. P.F. 

2. E.R. 

3. A.K. 

10	Demolimi i rrethojave ekzistuese që gjenden, anash rrugës. Në këtë pozicion janë përfshirë rrethojat ekzistuese nga profilet metalike të vendosura në mure. Në kuadër të këtij pozicioni përfshihet prerja, demontimi i rrethojës, demolimi i mureve me lartësi mesatare h=1.0 m (nga bllokat, tuallat dhe betoni) së bashku me themele nga betoni i armuar, si dhe transporti i materialeve të demoluara deri në deponinë e përcaktuar nga investitori me largësi deri në 15 km.	m	260.00	20.00	5,200.00
11	Prerja dhe demontimi i rrethojave metalike të vendosura mbi mure si dhe deponimi i të njëjtes deri në rimontim. Në kuadër të këtij pozicioni të parashihet edhe demolimi i mureve rrethuese ekzistuese (blloka, tulla dhe betoni), si dhe demolimi i themeleve shiritore nga betoni i armuar dhe transporti i materialeve të demoluara deri në deponi të përcaktuar nga investitori me largësi max 15 km. Muret kanë lartësi mesatare h=1.00 m. Po ashtu në kaudër të pozicionit të parashihet edhe ndërtimi i mureve të reja në skajin e trotuarit, me material të njëjtë si ato të demoluara si punimi i themelit murit dhe trarëve si dhe rivendosja e rrethojës duke llogaritur të gjitha punët dhe material e nevojshme për montim.	m	95.00	100.00	9,500.00
12	Prerja dhe demontimi i rrethojave metalike, deponimi dhe ruajtja e tyre deri në rimontim. Në kuadër të këtij pozicioni parashihet edhe demolimi i themeleve të veçuara nga betoni dhe transporti i materialit të demoluar në deponi të përcaktuar nga investitorit max 15km. Po ashtu në këtë pozicion të llogaritet edhe punimi i themeleve të reja për zhvendosjen e rrethojës në skajin e trotuarit dhe rivendosja e rrethojës duke përfshirë të gjitha punët dhe materialet për realizimin e këtij pozicioni.	m	250.00	100.00	25,000.00
13	Demolimi dhe zhvendosja e rrethojave, me tel dhe shtylla nga materiali i betonit, druri dhe profilet metalike. Në kaudër të këtij pozicioni përfshihet demontimi, demolimi dhe rivendosja e rrethojave duke përfshirë të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për realizim të pozicionit.	m	147.00	2.00	294.00

1. P.F.

2. E.Q.

3. A.K.

14	Demolimi, prerja dhe zhvendosja e murve nga betoni i armuar me lartësi mesatare h=150 cm dhe trashësi mesatare t=25 cm duke përfshirë edhe demolimin e themelvet si dhe transporti i materialit të demoluara deri në deponi të materialeve inerte të përcaktuar nga investitori, max 15km. Në këtë pozicion përfshihet edhe ndërtimi i mureve të reja në skajin e trotuare duke përfshirë të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për ndërtimin e mureve së bashku me themele me dimensione dhe gjatësi të njëjtë me ato të demoluara. Llogari bëhet për m gjatësi të murit të demoluara.	m	80.00	200.00	16,000.00
15	Demolimi i mureve nga bllokat dhe tuallat e argjilës, së bashku me elementet nga betoni i armuar si themele dhe shtylla dhe transporti i materialit të demoluara deri në deponi të materialeve inerte të caktuar nga investitori me transport max 15 km. Muret kanë lartësi mesatare h=150 cm. Në këtë pozicion përfshihet edhe ndërtimi i mureve të reja në skajin e trotuare duke përfshirë të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për ndërtimin e mureve së bashku me themele me dimensione dhe gjatësi të njëjtë me ato të demoluara. Llogari bëhet për m gjatësi të murit të demoluara.	m	60.00	150.00	9,000.00
16	Demolimi i terasave verore të lokaleve dhe transporti i materialeve të demoluara në deponi të përcaktuar nga investitori max 15km. Në këtë pozicion përfshihet demolimi i konstruksioneve të përkohshme si: mureve, mbulesës, bazës dhe themeleve. Llogaria bëhet në sipërfaqe të bazës së terasës pa marr parasysh lartësinë dhe elementet që demolohen.	m ²	93.80	20.00	1,876.00
17	Demolimi i rrjetit të ndriçimit publik, duke përfshirë: - Demontimi i shtyllave të ndriçimit publik, së bashku me lirë, dhe transporti i tyre në depo të përcaktuar nga investitori. - Demolimi dhe largimi i kablove elektike të rrjetit të ndriçimit dhe transporti i materialit në deponi të përshtatshme për materiale elektrike të përcaktuar nga investitori. Përveç kablilit gjatësor, duhet të bëhet edhe largimi i kablove, deri në kutin e furnizimit si dhe kablove tjera të këtij rrjeti që gjenden në trupin e rrugës, si dhe të bëhet shkyqja e kablove të furnizimit në piken e kyçjes. - Demolimi i kutive të shpërndarëse të rrjetit të ndriçimit dhe transporti i tyre në deponi të përshtatshme të përcaktuar nga investitori. - Thyrja dhe demolimi i bazamenteve nga betoni, si atyre të shtyllave të ndriçimit ashtu edhe të kutive shpërndarëse, si dhe transporti i materialit deri në deponi të materialeve inerte.	komplet	1.00	3,000.00	3,000.00

1. RF Pshlyj

2. E. Q. E. Q.

2.

3.

18	Demolimi i kanalizimit atmosferik ekzistues me të gjitha elementet përcjellëse, e ku përfshihet: - Demolimi i pusetave së bashku me konuse dhe kapak si dhe kenetave dhe bazave, gjithsejt 45 puseta, - Largimi i gypave të betonit si atyre të kolektorit dhe atyre të ujëmbledhësve me diametër nga Ø200 deri në Ø800, - Demolimi i pusetës së ujëmbledhësve së bashku me grillën metalike, gjithsejt 72 copë, Po ashtu në kuadër në kuadër të këtij pozicioni përfshihet edhe transporti i materialeve deri në deponitë përkatëse të përcaktuara nga investitori me transport deri në max. 15 km. Llogaria të bëhet për metër gjatësi të kolektorit kryesore.	m	1,700.00	2.00	3,400.00
19	Demolimi i pllakave të sipërme të pusetave të rrjetit të ngrohtores së qytetit. Pllakat janë nga betoni i armuar me trashësi mesatare $t=20$ cm dhe dimensione të bazës mesatarisht $B \times L = 2.00 \times 2.50$ m. Demolimi i pllakave të pusetave duhet të bëhet me kujdes që të mos dëmtohen gypat dhe pjesët tjera fazonerike që gjenden në pusetë, dhe në rast dëmtimi, punëkryesi duhet të bëjë sanimin e tyre. Në këtë pozicion përfshihet edhe demontimi dhe largimi kapakëve rrethor të pusetave (mesatarisht 2 kapakë për pusetë), si dhe transporti i materialeve deri në deponi të caktuar nga investitori max 15km.	copë	8.00	100.00	800.00
20	Demolimi i bazave nga betoni, që gjenden në trasenë e rrugës, si bazamente të reklamave, shtyllave etj, në këtë pozicion përfshihet thyerja, prejra, demolimi dhe transporti i materialeve deri në deponi të materialeve inerte të përcaktuar nga investitori max 15km. Bazamentet kanë dimensione mesatarisht $B \times L = 2.0 \times 1.50$ dhe trashësi mesatare $t=0.80$ m.	copë	4.00	50.00	200.00
21	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese të instalimeve ekzistuese si përgjatë rrugës ashtu edhe në kryqëzimet të cilat trajtohen sipas niveletës së projektuar, duke përfshir demontimin dhe deponimin e kapakut, demolim dhe ngritjen e kokës së pusetës dhe rivendosjen e kapakëve në nivelin e ri.	copë	11.00	75.00	825.00
22	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese të instalimeve ekzistuese si përgjatë rrugës ashtu edhe në kryqëzimet të cilat trajtohen sipas niveletës së projektuar, duke përfshir demontimin dhe deponimin e kapakut, demolim dhe ngritjen e kokës së pusetës dhe rivendosjen e kapakëve të ri deri 25t në nivelin e ri.	copë	4.00	75.00	300.00

1. P.F. *[Signature]*
2. E.A. *[Signature]*
3. A.L. *[Signature]*

23	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese të instalimeve ekzistuese si përgjatë rrugës ashtu edhe në kryqëzimet të cilat trajtohen sipas niveletës së projektuar, duke përfshir demontimin dhe deponimin e e kapakut, demolim dhe ngritjen e kokës së pusetës dhe rivendosjen e kapakëve të ri deri 42t në nivelin e ri.	copë	5.00	80.00	400.00 €
24	Demontimi i shtyllave ekzistuese të betonit të TU bartja dhe dorëzimi në depo të përcaktuar nga investitori.	copë	2.00	120.00	240.00
25	Demontimi i shtyllave ekzistuese të drurit të vjetra të TU bartja dhe dorëzimi në depo të përcaktuar nga investitori.	copë	3.00	120.00	360.00
26	Demontimi i dhe zhvendosja e shtyllave ekzistuese në pozitën e re jashtë trupit të rrugës, duke përfshirë të gjitha materialet dhe punët për realizim të këtij pozicioni	copë	4.00	120.00	480.00
27	Demontimi i dhe zhvendosja e shtyllave ekzistuese në pozitën e re jashtë trupit të rrugës dhe zevendesimi i tyre me shtylla të betonit me lartësi deri H=9m, duke përfshirë të gjitha materialet dhe punët për realizim të këtij pozicioni	copë	4.00	200.00	800.00
28	Inçizimi gjeodezik dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar).	m'	1,570.00	2.50	3,925.00

Gjithsej totali me TVSH

140,007.50

II	Punët e Tokësore dhe të gërmimit				
1	Prerja e asfaltit ekzistues në udhëkryqe dhe në vendet e parapara sipas projektit për realizimin e kyoqeve sipas niveletës së projektuar si dhe realizimin e depërimit të instalimeve në rrugët ekzistuese. Llogaria është bërë për gjatësi të visë së prerjes.	m	265.00	2.00	530.00
2	Gerryerja dhe demolimi i shtresave të asfaltit ekzistues si dhe transporti i materialit të demoluar në deponi të materialeve të përcaktuar nga ana e investitorit, max. 15 km. Rruga ka dy shtresa asfalt dhe atë me trashësi 8+4 cm të cilat duhet të gërryhen (demolohen). Në këtë pozicion përfshihet edhe rrethrotullimi në kryqëzim me rrugë UÇK si dhe udhëkryqet.	m²	18,240.00	3.00	54,720.00
3	Gerryerja e shtresave të asfaltit ekzistues në rrugët anësore për realizimin e kyoqeve. Në rrugët anësore duhet të bëhet largimi i shtresave për gjatësinë e nevojshme për realizimin dhe nivelizimin e udhëkryqeve sipas niveletës së projektuar. Gjatësia mesatare e gërryerjes L=5.00 m dhe gjërësia mesatare B=6.00 m. Materiali i demoluar duhet të transportohet në deponi të materialeve inerte të përcaktuar nga investitori, max. 15 km. Rrugët kanë dy shtresa asfalt dhe atë me trashësi 8+4 cm të cilat duhet të demolohen.	m²	600.00	3.00	1,800.00

1. P.F. *Phubing*
2. E.Q. *Qerashid*
3. A.K. *AK*

4	Gerryerja i shtresave finale të asfaltit ekzistues në rrethrotullimin në kryqëzimin e transitit me rrugën "Skenderbeu" si dhe transporti i materialit të demoluar në deponi të materialeve të përcaktuar nga ana e investitorit, max. 15 km. Gerryerja duhet të behet me trashësi max. t=4.00 cm.	m ²	1,347.00	2.00	2,694.00
5	Demontimi dhe largimi i kubzave ekzistuese me trashësi t=8 cm në rrugët anësore si dhe në pllato të ekzistuese të cilat janë të shtruara me kubza, si dhe deponimi i tyre deri në rimontim pas pështatjes së niveletës me rrugën e projektuar në rrugët anësore. Në këtë pozicion parashihet edhe shtresa e rërës për rivendosjen e kubzave.	m ²	850.00	6.00	5,100.00
6	Gërmimi i shtresave të rruges ekzistuese në trupin e rrugës me tmes=30 cm. Materiali gurorë duhet të deponohet në vendin e caktuar nga investitori, ndërsa materiali i gërmuar e që kanë përmbajtje të argjilë, si shiritat e gjelbërimit duhet të transportohet deponi te përshtatshme në largësi deri në 15km.	m ³	12,638.50	5.00	63,192.50
7	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV në trupin e rrugës, bartja e tij në deponi të përshtatshme në largësi deri në 15 km. Pjesa e materialit të gërmuar e cila është me përmbajtje gurorë mund të përdoret për mbushje në profilet ku mbushja është më e madhe se t=1.0m. Në këtë pozicion është llogaritur edhe gërmimi i dheut për hapjet e themeleve të mureve rezistuese dhe atyre dekorative dhe kyqjeve anësore.	m ³	26,014.01	5.00	130,070.07
